

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr. Br. 729/20
 Datë/Datum. 28.09.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Ankese Kunder: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	622-20-2058-2-1-1
Nr i brendshëm	622-20-028-211

Sa i përket tenderit për

Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Nabs Shpk & Detas D.o.o

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. Luan Haradinaj Sol. 1 Hy.1 nr.4

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 933 400

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Gent Pupa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

25.09.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e njoftimi per kontrate: 18.08.2020
Data e dorezimit te tenderit: 26.06.2020
Data e vendimit te AK: 09.09.2020
Data e kerkesekes per rishqyrtim: 13.09.2020
Data e pergjigjes se AK: 17.09.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Nuk ka verjtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Me datë 13.09.2020, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK, Mirepo kërkesa jone është refuzuar, pa arsyetuar fare se pse nuk i plotësojmë kërkesën edhe pse i kanë të gjitha dokumentacionet relevante.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave
Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtatni rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me datë 09.09.2020 kemi pranuar njoftimin për tenderuesin e eliminuar dhe ne të njëjten kohë njoftimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Ne letren standarde të dërguar nga ana e AK, thuhet se jemi eliminuar sepse nuk e kemi plotësuar vlerën e referencave.

Ak me këto rast nuk e ka specifikuar fare se cilat referenca nuk i ka pranuar apo cilat

referenca nuk e plotesojne kerkesen e AK.

Ne ne dosje te tenderit e kemi prezantuar nje liste te referencave ku jane preantuar projektet e realiuara nga partneri ne konorcium detas dleds i cili ne te njejten kohe eshte edhe prodhues i tyre.

Ne listen e prezantuar nuk e dijme se cka keni pas te pa qarte dhe se cila reference sipas AK nuk e plotesojn kerkesen, pasi e ne letren eliminuese nuk e keni permendur se cka nuk kemi plotesuar.

Ne ne kerkesen per rishyrtim, perseri edhe nje here ja kemi derguar listen e referencave dhe referencat qe kane qene pjese e dosjes se tenderit.

Ne pergjigjen e tyre AK, nuk e ka kuptuar natyren e projektit. Referencat jane per projektete ESCO, qe jane partneritete publiko private, me legjislacion te Bashkimit European.

Ne referenca shume qarte shkruan se projektet jane kryer per qytetet Gottolengo, dhe Goffredo te komunes se MANTOVA,

Te dy referencat jane te vertetuara nga inxhinieri mbikeqyres Ing. Renato Borrini i komunes se MANTOVA.

Nese AK ka dyshuar ne vertetesine e referencave, i kane te gjitha kontaktet ne referenca dhe mund ti vertetojne duke i kontaktuar direkt komunen e Mantoves ne ITALI.

Ak nuk e ka kuptuar cka d.m.th. kontrata ESCO, Partneriteti Publiko Privat sipas legjislacionit te BE, per ndricim publik, ne te cilin eshte nenshkruese e kontrates kompania DETAS. Dhe per eshte leshuar edhe referenca.

Edhe njehere po ju bashkangjisem, listen e referencave dhe referencat qe jane dorezuar me projekt.

Subject: **LIST OF REFERENCES**

Nr	Client	Description	Value	Year
1	Pederzani Impianti SRL – Italy	Delivery of Energy Saving LED Street lights and implementation of system for management and dimming of LED street light for the city of GOTTOLENGO	623,616.66 €	2020
2	Pederzani Impianti SRL – Italy	Delivery of Energy Saving LED Street lights and implementation of system for management and dimming of LED street light for the city of GOFFREDO	1,456,039.32 €	2019
3	Polion D.o.o	Delivery of LED street lights	1,035.076.10 €	2018
4	Tangentia D.O.O	Delivery of LED street lights	39,100.00 €	2019

Kerkojme nga organi shqyrtues i prokurimit qe ankesen tone ta aprovoje si te bazuar dhe lenden ta kthej ne rivleresim, pasi qe i plotesojme te gjitha kekesat e kerkuara ne dosje te tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkëlja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Tani per tani te papercaktuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.